



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

MBI MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL 2024-2026 BASHKIA BERAT

Të nderuar këshilltarë ,

Drejtoria e Shërbimit Social, në mbështetje të “Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2022-2023”, Ligjin nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", VKM-në nr. 518, date 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, Ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”, Ligjin nr.18/2017 “Për të drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, Ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”, Ligjin nr. 47/2018 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, Ligjin “Për barazinë gjinore”, VKM-në nr. 111, datë 23.2.2018 “Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social”, VKB nr.60 datë 21.12.2023 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2024 dhe PBA përfundimtare 2024-2026”.

JU RELATON :

Të nderuar këshilltarë ,

Plani Social i bashkisë Berat 2024-2026 u hartua në përputhje me legjislacionin, strategjitë dhe standardet kombëtare të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe prioritetet e përcaktuara nga bashkia për t’iu përgjigjur në mënyrë të përshtatshme dhe cilësore nevojave në rritje të komunitetit për këto shërbime.

Ky është tashmë plani i tretë social që Bashkia e Berat harton, në vazhdim të Planit Social 2019-2023, i cili vendosi themele të rëndësishme në kuadrin e ndërtimit të strukturave të shërbimeve shoqërore vendore, përmirësimit të shërbimeve ekzistuese e ndërtimit të shërbimeve të reja, si qendra komunitare, shërbime për gratë e dhunuara e fëmijët në nevojë për mbrojtje, në bashkëpunim me palët e treta, disa prej tyre të mbështetura nga Fondi Social, përmes aplikimeve të suksesshme. Hartimit të planit të tretë i parapriu një procesi vlerësimit të nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror, me disa hapa, i cili identifikoi karakteristikat e grupeve në nevojë, shërbimet ekzistuese që iu ofrohen, dhe kapacitetet e bashkisë për të zhvilluar sistemin e shërbimeve të

kujdesit shoqëror. I gjithë procesi i vlerësimit të nevojave dhe hartimit të planit u realizua në periudhën qershor – dhjetor 2023, nga grupi lokal i Bashkisë Berat të përbërë nga Drejtoria e Shërbimit Social dhe aktorë relevantë të shëndetësisë, arsimit, punësimit dhe organizatave jofitimprurëse, që operojnë në territorin e bashkisë dhe bashkëpunojnë me të, mbështetur nga UNDP në kuadër të projekteve dhe Fondit Social.

Vlerësimi i nevojave identifikoi grupet kryesore më në nevojë për shërbime të cilët janë: pjesëtarë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, persona me aftësi të kufizuara, fëmijë në nevojë për mbrojtje, komuniteti rom dhe egjiptian, viktimat të dhunës në familje, të moshuar në nevojë për përkujdesje, përdorues të drogës/alkoolit dhe viktimat të trafikimit etj.

Misioni është që Bashkia Berat përmes angazhimit të burimeve njerëzore e financiare të nevojshme, zhvillimit të partneritetit aktiv me çdo institucion publik që ka role e përgjegjësi specifike ligjore kundrejt individëve në nevojë për shërbime, do të thellojë e përmirësojë sistemin aktual të shërbimeve të kujdesit shoqëror për të mbrojtur, fuqizuar e riintegruar çdo individ të rrezikuar nga varfëria apo përjashtimi social.

Ndërsa vizioni është që të ngrihen sisteme komunitare shërbimesh të kujdesit social efektiv dhe gjithëpërfshirës që adreson nevojat në ndryshim të individëve në rrezik nga varfëria apo përjashtimi social duke u mundësuar sipas nevojës fuqizim, reabilitim, riintegrim në jetën ekonomike dhe sociale.

Për të përmbushur vizionin dhe misionin e Planit Social të bashkisë Berat 2024-2026, në Planin e Veprimit për këtë periudhë, është parashikuar arritja e tre qëllimeve kryesore: 1) përmirësimi i kushteve për zhvillimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashkinë Berat; 2) përmirësimi i shërbimeve sociale në territorin e bashkisë të Beratit; 3) zhvillimi i komponentit parandalues të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat prezantohen në plan të shoqëruar me objektivat e lidhura me çdo qëllim, aktivitetet për realizimin e tyre, dhe aktorët përgjegjës.

Bashkia Berat do të ndërtojë strukturat e nevojshme për ofrimin e shërbimeve shoqërore në nivelin e njësisë administrative, përmes ngritjes së strukturës kordinuese në nivel drejtorie, punësimit të punonjësve social në çdo njësi dhe ngritjen e skuadrave të njësive të vlerësimit nevojave dhe referimit (NJVNR).

Bashkëngjitur gjeni Planin Social dhe Buxhetin Bashkia Berat 2024-2026.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI I BASHKISË**

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë _____ 2024

MBI MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL 2024-2026 BASHKIA BERAT

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës ____ . ____ .2024, në mbështetje të “Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2022-2023”, Ligjin nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", VKM-në nr. 518, date 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, Ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”, Ligjin nr.18/2017 “Për të drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, Ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”, Ligjin nr. 47/2018 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, Ligjin “Për barazinë gjinore”, VKM-në nr. 111, datë 23.2.2018 “Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social”, VKB nr.60 datë 21.12.2023 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2024 dhe PBA përfundimtare 2024-2026”.

V E N D O S I:

- I. Miratimin e Planit Social 2024-2026 Bashkia Berat.
- II. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet drejtoria e Shërbimit Social.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK
Ervin Ceca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

Nr. _____, datë _____ 2024

MBI MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL 2024-2026 BASHKIA BERAT

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës ____ . ____ .2024, në mbështetje të “Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2022-2023”, Ligjin nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", VKM-në nr. 518, date 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimim e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, Ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”, Ligjin nr.18/2017 “Për të drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, Ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”, Ligjin nr. 47/2018 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, Ligjin “Për barazinë gjinore”, VKM-në nr. 111, datë 23.2.2018 “Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social”, VKB nr.60 datë 21.12.2023 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2024 dhe PBA përfundimtare 2024-2026”.

V E N D O S I:

- I. Miratimin e Planit Social 2024-2026 Bashkia Berat.
- II. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet drejtoria e Shërbimit Social.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK
Ervin Ceca

Këshilli i Bashkisë e miratoi me : ____ Vota Pro, ____ Vota Kundër, ____ Vota Abstenim



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

MBI MIRATIMIN E KRITEREVE TË DHËNIES SË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK - NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 % DHE NGA FONDET E DREJTORISË SË SHËRBIMIT SOCIAL.

Të nderuar këshilltarë ,

Drejtoria e Shërbimit Social, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 8/2, 9 pika 1.1, gërma “b”, 21, 64 gërma “c” , të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019, i ndryshuar date 29.12.2021, kreu IV, pika 1, 2 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”. si dhe VKM nr.8 datë 14.01.2015 i ndryshuar në datë 15.01.2019 “Për mbrojtjen e Shtresave në Nevojë, për efekt te heqjes së Fashës së Kompesimit të Energjisë Elektrike deri në 300 këh në muaj” . VKB nr.60 datë 21.12.2023 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2024 dhe PBA përfundimtare 2024-2026”.

JU RELATON :

- I. Miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 % dhe nga fondet e drejtorisë së shërbimit social si më poshtë:
 1. Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit.
 2. Familje me kryefamiljare gra në vështirësi ekonomike dhe sociale.
 3. Familje që kanë në përbërje anëtarë mbi moshë pune.
 4. Familjet ose individët që kanë një pension të ulët.
 5. Familje me shumë fëmijë.
 6. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë që ndjekin arsimin bazë dhe universitar.

7. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë me paaftesi/invalide pune.
 8. Familje që kanë një anëtar dhe janë të braktisur ose të vetmuar.
 9. Familjet të rikthyera nga emigracioni ose azil kërkuese që i përkasin komunitetit rom/egjiptian dhe mazhorancë.
 10. Familje shumë të varfëra që për arsyeje të ndryshme nuk arrijnë të aplikojnë sipas ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019, i ndryshuar date 29.12.2021 “Për përcaktimin e proçedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, këto familje do të trajtohen **nga fondet e buxhetit vendorë duke vijuar si më poshtë :**
- II. Dokumentat e aplikuesve të jenë sipas ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 597 datë 04.09.2019, i ndryshuar date 29.12.2021 “Për përcaktimin e proçedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.
- III. Masa e ndihmës ekonomike të llogaritet sipas VKM nr. 597 date 04.09.2019, i ndryshuar date 29.12.2021 “Për përcaktimin e proçedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.
- IV. Dokumentat e aplikusve për piken **10** janë : Certificate familjare, fotokopjen e kartës së identitetit, vërtetim nga Njësia Administrative (vërtetim vendbanimi) ose SPZ e zonws ku banon, dokumenta të ndryshem nga institucionet shëndetësore dhe institucione të tjera vendore ose lokale, verifikime në sistemin e-albania dhe formularin e paraqitjes mujore Mod 2, të ligjit nr.9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” të ndryshuar.

PËRGJEGJËSI I SEKTORIT TË N.E/PAK/INV

Evgjeni Pelivani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Adresa: Div. Bashkia e Beratit, Rr. Dëshmorët e Kombit, 60100 Berat, Shqipëri, Tel: 00355(0) 2 92 57 935, Website: www.bashkiaiberat.gov.al, Email:

bashkiaberat@yahoo.com

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI I BASHKISË**

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë _____ 2024

**MBI MIRATIMIN E KRITEREVE TË DHËNIES SË NDIHMËS EKONOMIKE NGA
FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK - NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 % DHE
NGA FONDET E DREJTORISË SË SHËRBIMIT SOCIAL.**

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës _____._____.2024, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 8/2, 9 pika 1.1, gërma “b”, 21, 64 gërma “c”, të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019, i ndryshuar date 29.12.2021, kreu IV, pika 1, 2 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”. si dhe VKM nr.8 datë 14.01.2015 i ndryshuar në datë 15.01.2019 “Për mbrojtjen e Shtresave në Nevojë, për efekt të heqjes së Fashës së Kompesimit të Energjisë Elektrike deri në 300 këh në muaj” . VKB nr.60 datë 21.12.2023 “Per miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe PBA përfundimtare 2024-2026”.

V E N D O S I:

- I. Miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 % dhe nga fondet e drejtorisë së shërbimit social si më poshtë:
1. Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit.
 2. Familje me kryefamiljare gra në vështirësi ekonomike dhe sociale.
 3. Familje që kanë në përbërje anëtarë mbi moshë pune.
 4. Familjet ose individët që kanë një pension të ulët.
 5. Familje me shumë fëmijë.

6. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë që ndjekin arsimin bazë dhe universitar.
 7. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë me paaftesi/invalide pune.
 8. Familje që kanë një anëtar dhe janë të braktisur ose të vetmuar.
 9. Familjet të rikthyera nga emigracioni ose azil kërkuese që i përkasin komunitetit rom/egjiptian dhe mazhorancë.
 10. Familje shumë të varfëra që për arsyeje të ndryshme nuk arrijnë të aplikojnë sipas ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019, i ndryshuar date 29.12.2021 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, këto familje do të trajtohen **nga fondet e buxhetit vendorë duke vijuar si më poshtë :**
- I. Dokumentat e aplikuesve të jenë sipas ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 597 datë 04.09.2019, i ndryshuar date 29.12.2021 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.
 - II. Masa e ndihmës ekonomike të llogaritet sipas VKM nr. 597 date 04.09.2019, i ndryshuar date 29.12.2021 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.
 - III. Dokumentat e aplikuesve për piken **10** janë : Çertifikate familjare, fotokopjen e kartës së identitetit, vërtetim nga Njësia Administrative (vërtetim vendbanimi) ose SPZ e zonave ku banon, dokumenta të ndryshëm nga institucionet shëndetësore dhe institucione të tjera vendore ose lokale, verifikime në sistemin e-albania dhe formularin e paraqitjes mujore Mod 2, të ligjit nr.9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” të ndryshuar.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Ervin Ceca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

Nr. _____, datë _____ 2024

MBI MIRATIMIN E KRITEREVE TË DHËNIES SË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK - NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 % DHE NGA FONDET E DREJTORISË SË SHËRBIMIT SOCIAL.

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës _____._____.2024, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 8/2, 9 pika 1.1, gërma “b”, 21, 64 gërma “c”, të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019, i ndryshuar date 29.12.2021, kreu IV, pika 1, 2 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”. si dhe VKM nr.8 datë 14.01.2015 i ndryshuar në datë 15.01.2019 “Për mbrojtjen e Shtresave në Nevojë, për efekt të heqjes së Fashës së Kompesimit të Energjisë Elektrike deri në 300 këh në muaj” . VKB nr.60 datë 21.12.20223 “Per miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe PBA përfundimtare 2023-2025”.

V E N D O S I:

- I. Miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 % dhe nga fondet e drejtorisë së shërbimit social si më poshtë:
1. Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit.
 2. Familje me kryefamiljare gra në vështirësi ekonomike dhe sociale.
 3. Familje që kanë në përbërje anëtarë mbi moshë pune.
 4. Familjet ose individët që kanë një pension të ulët.
 5. Familje me shumë fëmijë.

6. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë që ndjekin arsimin bazë dhe universitar.
 7. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë me paaftesi/invalide pune.
 8. Familje që kanë një anëtar dhe janë të braktisur ose të vetmuar.
 9. Familjet të rikthyera nga emigracioni ose azil kërkuese që i përkasin komunitetit rom/egjiptian dhe mazhorancë.
 10. Familje shumë të varfëra që për arsyeje të ndryshme nuk arrijnë të aplikojnë sipas ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019, i ndryshuar date 29.12.2021 “Për përcaktimin e proçedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, këto familje do të trajtohen **nga fondet e buxhetit vendorë duke vijuar si më poshtë :**
- II. Dokumentat e aplikuesve të jenë sipas ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 597 datë 04.09.2019, i ndryshuar date 29.12.2021 “Për përcaktimin e proçedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.
- III. Masa e ndihmës ekonomike të llogaritet sipas VKM nr. 597 date 04.09.2019, i ndryshuar date 29.12.2021 “Për përcaktimin e proçedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.
- IV. Dokumentat e aplikuesve për piken **10** janë : Çertificate familjare, fotokopjen e kartës së identitetit, vërtetim nga Njësia Administrative (vërtetim vendbanimi) ose SPZ e zonës ku banon, dokumenta të ndryshëm nga institucionet shëndetësore dhe institucione të tjera vendore ose lokale, verifikime në sistemin e-albania dhe formularin e paraqitjes mujore Mod 2, të ligjit nr.9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” të ndryshuar.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Ervin Ceca

Këshilli i Bashkisë e miratoi me : ___ Vota Pro, ___ Vota Kundër, ___ Vota Abstenim



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE
FINANCIARE NË RAST FATKEQËSIE PËR SABAH LLANA**

Drejtorja e Shërbimit Social dhe Drejtorja e Financës, bazuar në kërkesën e bërë nga Qendra e Zhvillimit Rezidencial Berat, Bashkia Berat, Nr. 6553 Prot, datë 18.12.2023 , mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 24/1, neni 40/6, neni 54, neni 64/c, ligjin 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4; ligjin nr.57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë ”, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqërore komunitare e rezidenciale, kriteret procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e tyre për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, ”, VKB nr.60, datë 21.12.2023 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2024 dhe PBA përfundimtare 2024-2026”.

JU RELATOI:

Të nderuar këshilltarë!

Fëmija Sabah Llana, ka qënë banor i qytetit të Kavajës, lindur në datë 21.08.2005, në Kavajë, me numër personal ID K50821079M me adresë: ish “Fabrika e Qelqit” lagja nr.5 Kavajë por prej datës 06.06.2023 është institucionalizuar në Qendrën e Zhvillimit Rezidencial Berat me diagnozën prapambetje mendore e moderuar dhe cregullim i theksuar i sjelljes, agresivitate verbal dhe fizik.

I riu Llana vjen nga një familje me vështirësi ekonomike dhe sociale të theksuara, ku vitet e fundit sjellja e tij mjaft agresive ka vështirësuar jetesën në familje, por jo vetëm, edhe për banorët e lagjes ku banonte. Të ndodhur në këtë situatë institucionet e shërbimit social Bashkia Kavajë kanë kërkuar vendosjen në një institucion rezidencial për personat me aftësi ndryshe. I riu gjatë qëndrimit në Qëndrë ka paraqitur probleme shendetësore të herë pas hershme duke u dërguar në Spitalin Rajonal Berat për mjekim. Në datën 25.11.2023 është dërguar me urgjencë

në Spitali Rajonal Berat, pasi është ndjerë keq dhe nga infermieri i urgjencës është konfirmuar se i riu ka humbur jetën. Shkaku i vdekjes është konstatuar: vdekje e papritur nga shkaqe të panjohura.

Duke u bazuar në sa më sipër familja Llana, e gjendur në pamundësi ekonomike, varfëri të vazhdueshme, probleme sociale nuk mund të përballoj e vetme shpenzimet e varrimit dhe drejtoria e Shërbimit Social, propozon të mbështesë si rast fatkeqësie në shumën 55.000 (pesëdhjetë e pesë mijë) lekë.

Bashkëngjitur relacionit gjeni:

- 1.Kërkesa e Qendrës së Zhvillimit Rezidencial Berat.
2. Vlerësim social dhe të zhvillimit nga Qendra e Zhvillimit Rezidencial Berat.
- 3.Vlerësim social ekomonik nga Drejtoria e Shërbimit Social, Bashkia Kavajë.
4. Informacion mbi shkaqet e vdekjes nga Qendra e Zhvillimit Rezidencial Berat.
5. Certifikatë vdekje.
6. Faturë Tatimore Shitje AB. ZOGA SH.P.K.

DREJTOR I SHËRBIMIT SOCIAL

Piro Xheblati



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____ datë ____ / ____ /2024

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE
FINANCIARE NË RAST FATKEQËSIE PËR SABAH LLANA**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ____ . ____ .2024, bazuar në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 24/1, neni 40/6, neni 54, neni 64/c, ligjit 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4; ligjit nr.57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqërore komunitare e rezidenciale, kriteret procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e tyre për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, VKB nr.60, datë 21.12.2023 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2024 dhe PBA përfundimtare 2024-2026”.

VENDOSI:

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare të menjëhershme për përballimin e shpenzimeve në rast fatkeqësie, për të ndjerin Sabah Llana në shumën 55.000 (pesëdhjetë e pesë mijë) lekë.
2. Shuma prej 55.000 (pesëdhjetë e pesë mijë) do të përballohet nga buxheti i Drejtorisë së Shërbimit Social për vitin 2024.
3. Pagesa do të bëhet për llogari të subjektit AB ZOGA SH.P.K që mundësojë shërbimin e varrimit.
4. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimit Social.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Ervin Ceca

Këshilli i Bashkisë e miratoi me : ____ Vota Pro, ____ Vota Kundër, ____ Vota Abstenim



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. _____ datë ____/____/2024

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE
FINANCIARE NË RAST FATKEQËSIE PËR SABAH LLANA**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës _____.____.2024, bazuar në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 24/1, neni 40/6, neni 54, neni 64/c, ligjit 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4; ligjit nr.57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqërore komunitare e rezidenciale, kriteret procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e tyre për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, VKB nr.60, datë 21.12.2023 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2024 dhe PBA përfundimtare 2024-2026”.

VENDOSI:

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare të menjëhershme për përballimin e shpenzimeve në rast fatkeqësie, për të ndjerin Sabah Llana në shumën 55.000 (pesëdhjetë e pesë mijë) lekë.
2. Shuma prej 55.000 (pesëdhjetë e pesë mijë) lekë do të përballohet nga buxheti i Drejtorisë së Shërbimit Social për vitin 2024.
3. Pagesa do të bëhet për llogari të subjektit AB ZOGA SH.P.K që mundësojë shërbimin e varrimit.
4. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimit Social.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Ervin Ceca

Këshilli i Bashkisë e miratoi me : ____ Vota Pro, ____ Vota Kundër, ____ Vota Abstenim



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE PROJEKTEVE

RELACION

MBI MIRATIMIN E DHËNIES SË TITULLIT "QYTETAR NDERI" Z. PIRRO RUÇO.

Të nderuar Këshilltarë,

Bashkia Berat, në zbatim të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 54, pika 9,pika 1,pika b, Ligjit nr. 94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë", neni 9, propozon dhënien e titullit "Qytetar Nderi" për Z. Pirro Ruço.

Pirro Ruço është një biznesmen i njohur në fushën e argjendarisë, lindur më 27 .10 .1959.

"Argjendari Pirro" filloi aktivitetin në vitet 86' – 87, nëpërmjet një projekti me vlerë për të realizuar stemën e Kongresit të 9-të, me anë një makinerie të personalizuar pantograf për punime në miniaturë, duke shënuar dhe fillimet e suksesit të kësaj kompanie. Investimi i Z.Pirro Ruço në vitet '94-95, për të ndërtuar projektin e tij të madh dhe vizionar, për blerjen e setit teknologjik të laboratorit të parë të arit në Shqipëri, shënon dhe hapjen e aktivitetit. Ndërkohë që vula e cilësisë qëndron në medaljet dhe dekoratat për presidencën,si dhe punime artistike të cilat emërtuan një tjetër epokë të krijimtarisë dhe modernizimit të imazhit të institucioneve shtetërore.

Aktualisht, Pirro Ruço përveç markës tregtare,ka të regjistruar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale 13 Disenjo Industriale, duke përfshirë portrete të punuara në formë statuje deri tek motivet e dekorit me elementë të traditës sonë kombëtare,të cilat përdoren në produkte suvenire.

Z. Pirro Ruço vazhdoi të ishte avangard dhe i përkushtuar në modelimin sa me cilësor estetik të produkteve. Nga duart e tij rrjedh art i pastër, i gdhendur në suvenire të çmuara që duken si vepra të cilat i përkasin një muzeumi,duke pasuruar më shumë vlerat kulturore në vendin tonë.

Prodhimet e Argjendari Pirro janë përdorur edhe nga Bashkia Berat,duke prezantuar denjësisht vlerat e qytetit tonë në prezantime me personalitete të shquara ndërkombëtare.

Kryetari i Bashkisë Berat i propozon Këshillit Bashkiak dhënien e titullit "Qytetar Nderi" Z. Pirro Ruço me motivacionin "Për kontributin e pamasë në ruajtjen e traditës Shqiptare në punimet me gurë e materiale të çmuara, për ndikimin e veçantë në krijimin e dekoratave e titujve kombëtarë që ruajnë vlerat e së shkuarës, vlerësojnë të tashmen dhe do të trashëgohen me krenari në brezat e ardhshëm dhe për promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të qytetit të Beratit përmes veprave të krijuara me mjeshtëri".

Faleminderit,

KRYETARI I BASHKISË

Ervin DEMO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

KOMISIONI I SHPRONËSIMEVE

Berat, më ____ .01.2024

Relacion

PËR MIRATIMIN E SHPRONËSIMIT PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTËSHME PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKUALIFIKIMI URBAN I UNAZËS SË RE BERAT”


Të nderuar z/znj këshilltarë!

Në mbështetje të ligjit Nr. 8561, datë 25.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, VKM-së nr. 127 datë 23.03.2000 për “Përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, Bashkia Berat ka filluar procedurat e shpronësimit për interes publik për pasuritë pronë private, për gjithsej 144 pronarë dhe bashkëpronarë, të pronave të llojit “arë”, “ arë + truall”, “truall” dhe pronarë, të pronës së llojit “truall dhe ndërtesë”, të ndodhura në Zonat Kadastrale 8502 dhe 8504, për të cilat kerkohet miratimi juaj lidhur me vijimin e procedurave të shpronësimit për realizimin e projektit “Rikualifikimi urban i Unazës së Re Berat”.

Komisioni për formatimin e dokumentacionit për procedurat e shpronësimit për interes publik bazuar në dokumentacionin përkatës të projektit “Rikualifikimi urban i Unazës së Re Berat” dhe këqyrjen në vend, thekson se pronat private që preken nga realizimi i këtij projekti shtrihet në zonat kadastrale 8502 dhe 8504, duke filluar nga perëndimi në afërsi të Stadiumit të Vjetër, vazhdimi përgjatë argjinaturës së lumit Osum dhe rrugës “Santa Lucia Filipine”, pikërisht tek kryqëzimi e duke vazhduar në zonën e ish-pyjores dhe Zonën Kadastrale 8504 në Uznovë me dalje në rrugën “Antipatrea”, në afërsi të lokalit “Osumi”.

Projekti përfshin rikualifikimin urban të unazës së re e cila në një pjesë të konsiderueshme të saj zhvillohet në trupin e rrugës ekzistuese (një pjesë të rrugës Santa Lucia Filipine deri në kryqëzimin me rrugën e “ish-Pyjores”) dhe më tej rruga zhvillohet si aks i ri, në territore kryesisht agrare dhe bujqësore. Pra gjendja ekzistuese e terrenit ishte: në segmentin e parë kemi trup rruge me gjerësi që shkon deri në 10.5 m pa trotuare dhe pa ndricim dhe rrugë e çakulluar, ndërsa në pjesën e dytë kemi trase të re totalisht të rrugës në një territor toke bujqësore.

Projekti përfshin jo vetëm aksin kryesor që është rreth 4 km i gjatë por edhe akse të tjera si ai i rrugës “Avni Kondi”, që fillon nga qendra e lagjes “Uznovë“, tek karburanti e vazhdon përgjatë rrugës në drejtim të Ish-Bonifikimit, një aks që funksionon si aks kryesor për këtë zonë. Njëkohësisht pjesë e projektit janë edhe aksi i shëtitorës apo rrugës së biçikletave si dhe rruga bujqësore.





Realizimi i projekteve dhe investimeve në fushën e transportit rrugor është thelbësor për zhvillimin e qytetit dhe domosdoshmëri për të mundësuar rrjedhën sa më me efikasitet të trafikut rrugor. Ky investim do të jetë lehtësim për trafikun e qytetit duke shmangur qarkullimin e mjeteve të tonazhit të rëndë në aksin kryesor si dhe do të shërbejë si urë lidhëse dhe ndërmjetësuese midis qytetit të Beratit me qytetet e tjerë si Poliçani dhe Skrapari. Një investim i tillë është domosdoshmëri për qytetin tonë duke u nisur nga fakti që qyteti i Beratit ka vetëm një aks rrugor për lëvizjen e automjeteve dhe nëpërmjet këtij projekti do të bëhet e mundur ndryshimi dhe lehtësimi i transportit rrugor në qytet. Projekti **“Rikualifikimi urban i Unazës së Re Berat”**, përfshin rikualifikimin urban të unazës së re, një pjesë e konsiderueshme e të cilës zhvillohet në trupin e rrugës ekzistuese dhe më tej rruga zhvillohet si aks i ri në territore agrare dhe bujqësore.

Realizimi i objektit **“Rikualifikimi urban i Unazës së Re Berat”** kërkon shpronësimin e disa sipërfaqjeve, tokë “truall”, “arë” dhe “ndërtesë”, në pronësi private të cilat dodhen në kufij të rrugëve ekzistuese të zonës apo në brendësi të saj në parcela toke bujqësore private.

Pasuritë që preken nga investimi, pasuritë tokë “truall”, “arë” dhe “ndërtesë” me pronarë privatë, janë bashkëngjitur tabelës ku çmimet e shpronësimit përlllogariten dhe janë përcjellë nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat.

Në bazë të nenit 10 pika c) e ligjit nr. 8561 datë 25.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, kërkohet si pjesë e dokumentacionit nga Agjencia Shqiptare e Shpronësimit, edhe miratimi nga Këshilli

Bashkiak për shpronësimin e pronarëve që preken nga projekti " **Rikualifikimi urban i Unazës së Re Berat**". Pronarët dhe bashkëpronarët, pronarë të pronave private të llojit "arë", "truall" dhe "ndërtesë", do të shpronësohen për pjesët e pronave që do të preken nga projekti, bazuar në çmimet e miratuara sipas legjislacionit në fuqi, marrë me shkresë zyrtare nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat.

Vlera totale e shpronësimit është: 38,812,976 lekë për pronat që shpronësohen për 144 pronarë dhe bashkëpronarë, prona të llojit "arë", " arë + truall", "truall" dhe "truall - ndërtesë".

Fondi për përballimin e kostos financiare të shpronësimit do të përballohen nga Buxheti i Bashkisë.

Faleminderit

Përgatiti:
Kryetari i Komisionit
z. Luçjano Bojaxhiu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

KOMISIONI I SHPRONËSIMEVE

Berat, më ____ .01.2024

Relacion

PËR MIRATIMIN E SHPRONËSIMIT PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I URËS SË RE MBI LUMIN OSUM DHE RIKOSTRUKSIONI I RRUGËS GORICË-BILÇË, BASHKIA BERAT”.

Të nderuar z/znj këshilltarë!

Në mbështetje të ligjit Nr. 8561, datë 25.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, VKM-së nr. 127 datë 23.03.2000 për “Përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, Bashkia Berat ka filluar procedurat e shpronësimit për interes publik për pasuritë pronë private, për gjithsej 3 pronarë, të pronave të llojit “Arë” dhe “trull”, të ndodhura në Zonën Kadastrale 1217, për të cilat kërkohej miratimi juaj lidhur me vijimin e procedurave të shpronësimit për realizimin e projektit “**Ndërtimi i Urës së Re mbi Lumin Osum dhe Rikostruksioni i Rrugës Goricë-Bilçë, Bashkia Berat**”.

Komisioni për formatimin e dokumentacionit për procedurat e shpronësimit për interes publik bazuar në dokumentacionin përkatës të projektit “Ndërtimi i Urës së Re mbi Lumin Osum dhe Rikostruksioni i Rrugës Goricë-Bilçë, Bashkia Berat” dhe këqyrjen në vend, thekson se pronat private që preken nga realizimi i këtij projekti shtrihen në zonën kadastrale 1217.

Zona ku do të zhvillohet projekti “Ndërtimi i Urës së Re mbi Lumin Osum dhe Rikostruksioni i Rrugës Goricë-Bilçë, Bashkia Berat”, është kryesisht një hapësirë e anëlumit, e lirë e pa sistemuar, pjesërisht e mbuluar nga gjelbërimi rastësor.

Nëpërmjet këtij projekti do të realizohet lidhja me aks rrugor midis Beratit edhe Bilçës. Realizimi

i projektit, ndërtimi i kësaj ure synon të ulë fluksin e lëvizjes së automjeteve të cilat kalojnë përgjatë lagjjes “Goricë” dhe uljen e kohës për të shkuar në Bilçë. Përveç për sa më sipër ky projekt do të ndikojë gjithashtu duke përmirësuar impaktin vizual përreth zonës ku do të implementohet.

Si pjesë të projektit përfshihen edhe ndriçim publik si dhe korsi të dedikuara për biçikletat. Ky projekt do të realizojë rehabilitimin e hapësirën publike urbane aty ku do të implementohet, gjithashtu do të ndikojë në përmirësimin e siluetës urbane të zonës.

Kufiri i nderhyrjes





Realizimi i projektit "Ndërtimi i Urës së Re mbi Lumin Osum dhe Rikostruksioni i Rrugës Goricë-Bilçë, Bashkia Berat", nuk mund të realizohet pa kryer shpronësimin e disa sipërfaqeve të tokës të llojit "arë" dhe "truall", në pronësi të pronarëve privatë të cilat kufizohen me lumin Osum.

Gjendja ekzistuese



Rendera



Pasuritë që preken nga investimi, pasuritë tokë “truall” dhe “arë” me pronarë privatë, janë sipas tabelës ku çmimet e shpronësimit përlllogariten dhe janë përcjellë nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat.

Nr	Nr pasurie	Lloji i pasurise	Pronari	Siperfaqja/m ²	Cmimi /m ²	Vlera	Vlera totale
1	25/56	truall	Isuf Bariam Bejko	71.2	500	35.600	35.600
2	25/10	arë, truall	Ymer Hyka	68.25	500	34.125	34.125
3	25/46	arë	Florjan Nazmi Dervishaj	88.7	500	44.350	44.350

Në bazë të nenit 10 pika c) e ligjit nr. 8561 datë 25.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, kërkohet si pjesë e dokumentacionit nga Agjencia Shqiptare e Shpronësimit, edhe miratimi nga Këshilli Bashkiak për shpronësimin e pronarëve që preken nga projekti "Ndërtimi i Urës së Re mbi Lumin Osum dhe Rikonstruksioni i Rrugës Goricë-Bilçë, Bashkia Berat”. Pronarët e pronave private të llojit “arë” dhe “truall”, do të shpronësohen për pjesët e pronave që do të preken nga projekti, bazuar në çmimet e miratuara sipas legjislacionit në fuqi, marrë me shkresë zyrtare nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat.

Vlera totale e shpronësimit është 114.075 lekë për pronat që shpronësohen, të ndodhura në Zonën Kadastrale nr. 1217.

Fondi për përballimin e kostos financiare të shpronësimit do të përballohen nga Buxheti i Bashkisë.

Faleminderit

Përgatiti:
 Kryetari i Komisionit
z. Luçjano Bojaxhiu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

KOMISIONI I SHPRONËSIMEVE

Berat, më ____ .01.2024

Relacion

PËR MIRATIMIN E SHPRONËSIMIT PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTËSHME PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIVITALIZIMI I MJEDISEVE ATRAKTIVE NË FSHATIN MBRESHTAN, BASHKIA BERAT”

Të nderuar z/znj këshilltarë!

Në mbështetje të ligjit Nr. 8561, datë 25.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, VKM-së nr. 127 datë 23.03.2000 për “Përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, Bashkia Berat ka filluar procedurat e shpronësimit për interes publik për pasuritë pronë private, për gjithsej 14 pronarë dhe bashkëpronarë, të pronave të llojit “arë” dhe “ullishte”, të ndodhura në Zonën Kadastrale 2634, për të cilat kerkohet miratimi juaj lidhur me vijimin e procedurave të shpronësimit për realizimin e projektit “Rivitalizimi i Mjediseve Atraktive në Fshatin Mbreshtan, Bashkia Berat”.

Komisioni për formatimin e dokumentacionit për procedurat e shpronësimit për interes publik bazuar në dokumentacionin përkatës të projektit “Rivitalizimi i Mjediseve Atraktive në Fshatin Mbreshtan, Bashkia Berat” dhe këqyrjen në vend, thekson se pronat private që preken nga realizimi i këtij projekti shtrihet në zonën kadastrale 2634, objekti shtrihet në veri E 489808.18 , N 4509219.93 , në jug E 489985.98 , N 4508659.93, në lindje E 489970.58, N4508927.33 , në perendim E 489792.78 , N 4508865.73 , kordinatat e kufizimit janë në sistemin K,R,GJ,SH.

Segmenti i shëtitorës Mbreshtan lokalizohet në Bashkinë Berat. Ky segment ka një gjatësi prej 1.600 km. Shëtitorja shërben si një mjedis rekreacioni dhe çlodhje për qytetarët dhe vizitorët në

këtë zonë. Objektivi i projektit është ndërtimi i një shëtitorjeje rreth liqenit të Mbreshtanit duke synuar kështu zhvillimin e turizmit në zonë dhe më gjerë.

Segmenti “Shëtitorje e Rezervuarit Mbreshtan” shtrihet në territorin administrativ nën administrimin e Bashkisë Berat.

Ky segment fillon nga kurora e digës së Mbreshtanit dhe krijon një unazë, e cila mbaron përsëri po tek kjo kurorë.

Për përcaktimin e kuotës së rrugës janë përdorur të dhënat e përcaktimit mbi nivelin maksimal të ujit në liqen, gjithashtu janë përdorur edhe të dhënat topografike të tejpërplotësit (shkarkuesit katastrofik) të rezervuarit në krahun lindor të digës. Shëtitorja është projektuar në një kuotë më të lartë se ajo e tejpërplotësit të digës, duke siguruar kështu mbrojtjen nga përmytja.

Përgjete kësaj shëtitorjeje do të vendosen ndriçuesat rrugor dhe kosha mbeturinash, gjithashtu do të ketë mbjellje me bar, por duke lënë dhe bërë të mundur, që me kalimin e kohës komuniteti apo bashkia mund të mbjellë dhe pemë të ndryshme dekorative anash saj.

Kufiri i nderhyrjes



Gjendja ekzistuese





Realizimi i objektit “Rivitalizimi i Mjediseve Atraktive në Fshatin Mbreshtan, Bashkia Berat” kërkon shpronësimin e disa sipërfaqjeve, tokë “arë” dhe “ullishte”, në pronësi private të cilat do të preken nga implementimi i këtij projekti në zonën kadastrale 2634.

Pasuritë që preken nga investimi, pasuritë tokë “arë” dhe “ullishte” me pronarë privatë, janë bashkëngjitur tabelës ku çmimet e shpronësimit përlllogariten dhe janë përcjellë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat.

Në bazë të nenit 10 pika c) e ligjit nr. 8561 datë 25.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, kërkohet si pjesë e dokumentacionit nga Agjencia Shqiptare e Shpronësimit, edhe miratimi nga Këshilli Bashkiak për shpronësimin e pronarëve që preken nga projekti “Rivitalizimi i Mjediseve Atraktive në Fshatin Mbreshtan, Bashkia Berat”. Pronarët dhe bashkëpronarët, pronarë të pronave private të llojit “arë”, “ullishte”, do të shpronësohen për pjesët e pronave që do të preken nga projekti, bazuar në çmimet e miratuara sipas legjislacionit në fuqi, marrë me shkresë zyrtare nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat.

Vlera totale e shpronësimit është: 992,151 lekë për pronat që shpronësohen për 14 pronarë dhe bashkëpronarë, prona të llojit “arë” dhe “ullishte”.

Fondi për përballimin e kostos financiare të shpronësimit do të përballohen nga Buxheti i Bashkisë.

Faleminderit

Përgatiti:

Kryetari i Komisionit

z. Luçjano Bojaxhiu